



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/126  
Datë: 8 / 7 / 2024

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nenit 27 paragrafi 2 të Statutit të UP-së dhe Rregulloren me nr. prot. 754, datë 7.3.2024, për rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme të personelit akademik dhe joakademik në nivel të përfaqësimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 3.7.2024, mori vendim të shpallë:

**KONKURS**

***për zgjedhjen e rektorit të Univeristetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"***

**I. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:**

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, të profesorit të asocuar ose të profesorit asistent;
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare;
3. Të mos ketë qenë në pozita udhëheqëse në ndonjë parti politike apo në listë zgjedhore të ndonjë partie politike ose koalicioni në nivel qendror dhe lokal në tri (3) vitet e fundit.
4. Në pozitën rektor, nuk kanë të drejtë të zgjidhen kandidatët:
  - Të cilët janë dënuar për kryerjen e veprës penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - Që kanë të shqiptuar masë disiplinore nga organet kompetente të universitetit, në tre (3) vjetët e fundit, përfshirë masat e shqiptuara nga Këshilli i Etikës për personelin akademik;
  - Të cilëve u është shqiptuar masa e shkarkimit nga pozita që kanë ushtruar, në tre (3) vitet e fundit.

**II. Procedura e përzgjedhjes:**

1. Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm;
2. Komisioni profesional i zgjedhur nga Senati propozon listën prej kandidatëve të zgjedhur me shumicë votash, për t'u zgjedhur nga Këshilli drejtues;

3. Këshilli drejtues i interviston kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese;
4. Rektorin e zgjedh Këshilli drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej pesë (5) anëtarëve të cilin komision e formon Senati. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs;
5. Këshilli drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional duke arsyetuar atë;
6. Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit për shkak të konflikt të interesit aplikohet ligji në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
7. Rektori zgjidhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm) në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton shumicën absolute tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në këtë Statut;
8. Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë prej katër vitesh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Mandati i rektorit fillon me një tetor.

### **III. Kandidatët së bashku në kërkesë duhet t'i paraqesin këto dokumente:**

1. Biografinë e shkurtër;
2. Certifikatën ose ekstratin e lindjes;
3. Dokumentin e identifikimit;
4. Kopjet e diplomave apo dëshminë mbi përfundimin e studimeve pasuniversitare, sipas rastit (studimet jashtë vendit) dhe dëshminë e nostrifikimit të diplomave;
5. Vendimin/certifikatën apo ekuivalente të titullit akademik;
6. Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencor, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale në arsimin e lartë;
7. Dëshminë që nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe që nuk ka aktakuzë të ngritur.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në orën 16:00 në zyrën nr. 18 të ndërtesës së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Rr. "Xhorxh Bush", nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

**Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit në ueb-faqen zyrtare të UP-së, përkatësisht nga data 8.7.2024 deri më 22.7.2024, në orën 16:00.**

